



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2536, datë 15.01.2015

Për

“Miratimin e rinovimit të Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave të brezit 900 dhe 1800 MHz të sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 15.01. 2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimi i rinovimit të Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave të brezit 900 dhe 1800 MHz të sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a.”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 73 i ligjit nr. 9918. datë 19. 05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (*ligji nr. 9918*),
2. VKM Nr.496 datë 22.07.2014, për “Miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim”,
3. Ligji Nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”,
4. VKM Nr.466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”,
5. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.530 datë 26.12.2008, “Për Autorizimin Individual të Operatorit të Telefonisë së Lëvizshme GSM në Republikën e Shqipërisë – Albanian Mobile Communications sh.a.”,

6. Vendimi i Ndërmjetëm i Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2494, datë 14.08.2014,
7. Akti i dakortësisë përcjellë nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike me shkresën Nr.1277/10 Prot.AKEP, datë 19.01.2015,
8. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- 1- Relacioni përkatës sëbashku me materialet shkresore shoqëruese;
 - 2- Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N s e:

1. Referuar Vendimit Nr.530, datë 26.12.2008, “Për Autorizimin Individual të Operatorit të Telefonisë së Lëvizshme GSM në Republikën e Shqipërisë –“Abanian Mobile Communications sh.a.”, afati i vlefshmërisë së Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave GSM900 dhe GSM1800 ka përfunduar në datën 19.08.2014. Aktualisht AMC përdor brezin e frekuencave 900 dhe 1800 MHz bazuar në Vendimin e Ndërmjetëm të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2494, datë 14.08.2014.
2. Grupi adhoc i ngritur bazuar në Urdhrin Nr.4450, datë 24.11.2014 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ka nënshkruar aktin e dakortësisë me sipërmarrësin “Albanian Mobile Communications” sh.a., i cili është përcjellë në AKEP nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike me shkresën Nr.1277/10 Prot.AKEP, datë 19.01.2015.
3. Bazuar në procedurat e ligjit nr. 9918. datë 19. 05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM Nr.496 datë 22.07.2014, për “Miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim” dhe Raportin vlerësues të AKEP, AMC sh.a. ka përmbushur të gjitha kushtet e përdorimit të këtyre frekuencave (900 dhe 1800 MHz).
4. Kushtet teknike aktuale të shfrytëzimit të frekuencave të brezit 900 dhe 1800 MHz nga AMC janë ato të përcaktuara në VKD Nr.530, datë 26.12.2008.
5. Dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me përcaktimet e parashikuara në Rregulloren e Brendshme të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

1. Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
2. VKM Nr.466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave ”,
3. VKM Nr.496 datë 22.07.2014, për “Miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim”,
4. Akti i dakortësisë përcjellë nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike me shkresën Nr.1277/10 Prot.AKEP, datë 19.01.2015.

V E N D O S:

1. Të miratojë rinovimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave të brezit 900 dhe 1800 MHz të sipërmarrësit “Albanian Mobile Communications sh.a.” sipas Lidhjes bashkëlidhur.
2. Bazuar në neni 62 - Administrimi i spektrit të frekuencave, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipërmarrësi “Albanian Mobile Communications sh.a.” do të përdorë frekuencat e përcaktuara në këtë Autorizim Individual vetëm për sistemet GSM, derisa AKEP do të njoftojë me shkrim mbajtësin e këtij Autorizimi Individual për vendimin e rivlerësimit të kufizimeve.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Alketa MUKAVELATI** _____
3. **Benon PALOKA** _____
4. **Zamira NURÇE** _____